



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2021

V E N D I M

Nr. 258, datë 29.12.2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 105, datë 08.06.2021, e z. T.B., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat E. B, ku pretendohet diskriminim, për shkak të “*ankimit në gjykatë*” nga ana e Qendrës Shëndetësore Gramsh² dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale³.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesi T.B. ka punuar në pozicionin e mjekut pediatër pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, që prej vitit datës 12.11.1973. Pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, ankuesi ka bërë kërkesë për të punuar sërish pranë kësaj Qendre. Me shkresën datë 04.03.2020, Qendra Shëndetësore Elbasan i ka kërkuar Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan, shtyrjen e afatit të daljes në pension të Dr. T.B., duke theksuar se është i vetmi mjek pediatër që mbulon qytetin e Gramshit. Me shkresën nr. 514/44 prot., datë 24.04.2020, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka bërë të ditur se kërkesa nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kërkesa e ankuesit dhe e disa mjekëve të tjerë

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin QSH Gramsh;

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin MSHMS;

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

është refuzuar, për shkak të procedurës me të meta, që është ndjekur nga qendrat shëndetësore. Ministria ka orientuar Drejtoritë Rajonale rreth procedurave korrekte, që duhet të ndërmarrin përpara se të kërkojnë shtyrje të afatit për daljen në pension të mjekëve, që shfaqin vullnet për të punuar, pasi kanë mbushur moshën e pensionit.

Në vijim të kësaj përgjigjeje, Qendra Shëndetësore Gramsh ka zgjidhur marrëdhënien e punës me Dr. T.B. Zgjidhja e kontratës është bërë në mënyrë të menjëhershme, duke mos i njohur ankuesit asnjë kontribut dhe duke mos i caktuar asnjë shpërblim për vjetërsinë në punë. Për këtë arsye, ankuesi i drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ta zgjidhur çështjen gjyqësisht.

Në ankesë sqarohet fakti se para se t'i drejtohej gjykatës, ankuesi ka kërkuar nga Qendra Shëndetësore Gramsh ta rishikojë vendimin e saj, pasi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës së punës, por kryerjen e rregullt të procedurave para se të bëhej rinovimi i kontratës së punës. Gjatë kësaj periudhe kohore, MSHMS rishikoi vendimin dhe rekomandoi rilidhje të kontratës së punës për z. T.B. Shkëputja nga marrëdhënia e punës zgjati 3 muaj, arsye për të cilën edhe masa e dëmshpërblimit që u kërkuar gjyqësisht u kufizua në 3 paga, pa përfshirë këtu shpërblimin për vjetërsinë në punë.

Kontrata e re e lidhur me mjekun T.B. ishte një kontratë me afat të caktuar dhe përfundonte në datën 01.04.2021. Përpara përfundimit të afatit të përfundimit të kontratës së punës, ankuesi paraqiti kërkesë të re për shtyrje të kësaj kontrate, sikurse kishte bërë më parë, por kërkesa e tij për lidhje të kontratës së punës është refuzuar nga MSHMS.

Ankuesi, vë theksin në faktin, se mosrinovimi i kontratës së tij individuale të punës është bërë për shkak të ankimit të tij në gjykatë, kundër Qendrës Shëndetësore Gramsh. Sipas tij, në shkresën nr. 9, datë 26.01.2021, të kësaj Qendre drejtuar Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së Elbasan dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, këto institucione janë bërë me dije se procesi gjyqësor i nisur nga ankuesi dhe vleftha e shpërblimeve të kërkuara nga ai përbëjnë dëm ekonomik për Qendrën Shëndetësore Gramsh, si dhe ankuesi konsiderohej se kishte shkelur parimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit të përcaktuara në Kodin e Punës, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 28, datë 16.03.2021, Qendra Shëndetësore Gramsh e njofton ankuesin T.B., për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi afati i kontratës individuale të punës kishte përfunduar.

Mosrinovimi i kontratës së punës, pas përfundimit të kontratës paraardhëse me afat 6 mujor, pretendohet si diskriminim i mjekut T.B., për shkak të ankimit të tij në gjykatë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “përgjegjësisë prindërore” dhe “gjendjes shëndetësore”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë

⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Hapat proceduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 105, datë 08.06.2021, së z. T.B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁶, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Qendrës Shëndetësore Gramsh dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 860/2, datë 14.06.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 2. Kopje e librezës së punës dhe kontratës individuale të punës me afat të caktuar për z. T.B.;
 3. Kopje të kërkesave për punësim, pas mbushjes së moshës për pension, të z. T.B.;
 4. Kopje e praktikës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për z. T.B.;
 5. Informacion nëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është shprehur me vendim mbi padinë e ngritur nga ankuesi për shpërblim dëmi. Nëse po, lutemi të përcillet vendimi gjyqësor;
 6. Informacion mbi procedurën e ndjekur në rastet e mjekëve, që kërkojnë shtyrje të afatit për daljen në pension, pasi shfaqin vullnet për të punuar, edhe pasi kanë mbushur moshën e pensionit;
 7. Informacion mbi mënyrën se si është ndjekur kjo procedurë, në rastin kur, z. T.B. ka kërkuar për herë të dytë, rinovimin e kontratës së punës;
 8. Kopje e korrespondencës zyrtare të Qendrës Shëndetësore Gramsh dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me rastin e z. T.B..
 9. Arsyet e mos rinovimit të kontratës së punës me ankuesin, pas përfundimit të kontratës së parë me afat të caktuar;

⁶ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

10. Kopje e shkresës nr. 28, datë 16.03.2021 dhe shkresës nr. 9, datë 26.01.2021, së Qendrës Shëndetësore Gramsh;

- Në përgjigje të shkresës nr. 860/2, datë 14.06.2021, së KMD-së, Qendra Shëndetësore (QSH) Gramsh dërgoi informacionin e saj nëpërmjet shkresës nr. 860/3, datë 28.06.2021. Për sa më sipër, QSH Gramsh sqaron se ankuesi ka punuar mjek në Spitalin e qytetit të Gramshit nga viti 1973 dhe më pas pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, si mjek pediatër në Konsultorin e Fëmijës. Z. T.B. ka lindur më 14.03.1947 dhe ka mbushur moshën për pension pleqërie në datën 14.03.2012. Që nga ky moment ka vazhduar të punojë pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh me shtyrje të herëpashershme të kohës së daljes në pension, deri në datën 03.07.2020, kur janë ndërprerë marrëdhëniet e financiare, për shkak të mos miratimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të shtyrjes së mëtejshme të këtij afati. Ndërprerja e marrëdhënieve financiare me ankuesin ka zgjatur për një periudhë 3 (tre) mujore, pasi këto marrëdhënie janë lidhur sërish në datën 02.10.2020 me miratimin e dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për një shtyrje tjetër të kohës së daljes në pension të mjekut T.B.

Qendra Shëndetësore Gramsh e sqaron KMD edhe mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion në rastin e z. T.B., për shtyrjen e moshës për pension pleqërie. Shtyrja e parë e afatit është bërë me miratim të MSHMS, nëpërmjet shkresës nr. 2142/1, datë 30.05.2012, së këtij institucioni, menjëherë pasi mjeku kishte mbushur moshën për pension. Në bazë të këtij miratimi është kryer edhe lidhja e kontratës së punës me mjekun T.B. Me kërkesë të mjekut, duke vlerësuar edhe aftësitë e tij, si dhe duke marrë parasysh nevojat që kishte institucioni në mungesë të mjekëve, Qendra Shëndetësore i është drejtuar Drejtorisë së Shëndetit Publik (aktualisht emërtesa është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor), e cila e ka dërguar kërkesën për miratim në Drejtorinë Rajonale të OSHKSH⁷. Kjo e fundit e ka përcjellë kërkesën në fjalë pranë Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së dhe në vijim është MSHMS, që ka vendosur për miratimin, ose jo të kërkesës së ankuesit për shtyrjen e moshës për pension.

Pas marrjes së këtij miratimi, QSH Gramsh lidhi kontratë me afat të caktuar (6 mujore) me mjekun, duke theksuar qartë afatin e shtyrjes si dhe faktin se nëse gjatë kësaj periudhe do të paraqitej ndonjë kandidaturë tjetër për punësim, mjekut do t'i ndërpritej marrëdhënia e punës me institucionin. Kjo praktikë ka vazhduar të ndiqet përgjatë këtyre 8 viteve edhe me z. T.B., edhe pas krijimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, nëpërmjet VKM nr. 419, datë 04.07.2018.

Drejtoria Rajonale Elbasan e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor e ka njoftuar QSH Gramsh nëpërmjet shkresës nr. 366/4, datë 30.04.2020, se mbështetur në shkresën nr. 514/74, datë 24.04.2020 të Drejtorisë Qendrore të OSHKSH, me lëndë “Për njohje dhe zbatim”, kërkesa për shtyrje të kohës së daljes në pension për mjekun T.B. nuk është miratuar nga MSHMS. Pas këtij

⁷ Akronim i emërtesës “Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”;

njoftimi, drejtoresha e QSH Gramsh ka realizuar një takim me mjekun T.B.. Në vijim, në datën 02.07.2020, pranë QSH Gramsh dërgohet shkresa nr. 805/3, datë 27.06.2020, e Drejtorisë Qendrore të OSHKSH, bashkëlidhur së cilës ndodhej shkresa nr. 12/443 prot., datë 25.06.2020 e MSHMS me lëndë *“Refuzim kërkesë për shtyrje të kohës së daljes në pension”*. Në shkresën e MSHMS ndër të tjera thuhet se: *“...ky pozicion do të shpallet në platformën elektronike “Mjekë për Shqipërinë”....nëpërmjet së cilës bëhen dhe emërimet në personelin mjekësor pranë qendrave shëndetësore.*

Në shkresën e QSH Gramsh sqarohet se të gjendur para një fakti të tillë, ky institucion ka ndërprerë marrëdhëniet e financiare me paditësin nëpërmjet Urdhërit nr. 3, datë 03.07.2020. Më pas, MSHMS ka miratuar vazhdimin e marrëdhënieve të punës për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj për z. T.B., fakt, të cilin e ka bërë të ditur nëpërmjet shkresës nr. 12/819, datë 29.09.2020, me lëndë *“Miratim kërkesë”*. Në zbatim të kësaj shkrese, Drejtoresha e QSH Gramsh, nëpërmjet Urdhërit nr. 4, datë 02.10.2020 ka urdhëruar rilidhjen e marrëdhënieve të punës me mjekun duke nënshkruar kontratën individuale të punës më datë 02.10.2020. Në zbatim të kësaj kontrate, marrëdhëniet e punës ndërmjet QSH Gramsh dhe mjekut T.B. kanë vazhduar për 6 muaj, deri në datën 02.04.2021.

Në datën 24.12.2020, pranë QSH Gramsh ka mbërritur Dëftesa e Komunikimit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Aktin e njoftimit të padisë, regjistruar me nr. 13765/2020, datë 21.12.2020.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, se mos rinovimi i kontratës së punës së tij është bërë për shkak të ankimit në gjykatë kundër këtij institucioni, pasi procesi gjyqësor i nisur nga ankuesi dhe vleftha e shpërblimeve të kërkuara nga ai përbëjnë dëm ekonomik për qendrën, QSH Gramsh sqaron se ky institucion nëpërmjet shkresës nr. 9, datë 26.01.2021 i është drejtuar Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor , Drejtorisë Rajonale Elbasan si organ drejtues nga ku ajo ka vartësinë dhe për dijëni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fillimisht, QSH Gramsh i ka informuar këto institucione lidhur me faktin se mjeku T.B. ka ngritur padi kundër saj, si dhe e ka njohur me kërkesën e mjekut, i cili ka shprehur dëshirën për të vazhduar punën dhe në fund ka kërkuar nga ky institucion rekomandime të mëtejshme si vijon: *“Me qëllim final ofrimin e shërbimit shëndetësor për komunitetin por edhe ruajtjen e interesave të QSH që unë drejtoj, kërkoj nga ju rekomandime të mëtejshme pasi jam përballë një dileme nëse duhet ose jo të dërgoj kërkesën për shtyrje të kohës së daljes në pension të mjekut T.B..”*

Në shkresë vihet në dukje fakti se ky veprim i QSH Gramsh bazohet në Statutin e QSH, neni 8, detyrat e drejtorit të QSH, pika 3, ku përcaktohet se: *“Drejtori i Qendrës Shëndetësore është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë, si dhe për punën profesionale të QSH...”*, dhe pika 4, gërma c) ku parashikohet se: *“Lidh kontratat e punës me punonjësit e Qendrës Shëndetësore, bazuar në procedurat e rekrutimit të personelit të miratuara nga MSHMS”*. QSH Gramsh është institucion buxhetor dhe bazuar në nenin 7, pika 1, gërma a) të Statutit të QSH, ajo financohet nga Ministria

përgjegjëse për shëndetësinë. Për këtë arsye, QSH Gramsh ka detyrim të raportojë për çdo shpenzim të saj.

Qendra Shëndetësore Gramsh sqaron gjithashtu se shkresa nr. 514/44, datë 24.04.2020, së cilës i referohet ankuesi është dërguar bashkëlidhur shkresës nr. 366/4 prot., datë 30.04.2020 të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, sipas së cilës nuk përcaktohet se mosmiratimi i shtyrjes së kohës së daljes në pension për mjekun T.B. ka ardhur për shkak të procedurës me të meta, sikurse pretendohet nga ankuesi, por kjo shkresë bashkë me refuzimin i është dërguar Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan. QSH Gramsh sqaron se detyra e saj është të dërgoje kërkesën pranë institucioneve drejtuese dhe janë këto institucione përgjegjëse për zbatimin e procedurës.

Lidhur me çështjen e procesit gjyqësor që po zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, QSH Gramsh sqaron se gjykata ende nuk është shprehur me vendim.

Lidhur me procedurën që ndiqet në rastet e mjekëve që kërkojnë shtyrje të afatit për daljen në pension pleqërie, pasi shfaqin vullnet për të punuar edhe më tej, QSH Gramsh sqaron se me marrjen e kërkesës nga mjeku i interesuar e dërgon atë tek organet drejtuese dhe janë këto organe që shqyrtojnë dhe miratojnë ose jo kërkesat.

Qendra Shëndetësore Gramsh ka dërguar bashkëlidhur shkresës dokumentacionin e kërkuar nga KMD, përveç librezës së punës së ankuesit, e cila është tërhequr nga vetë z. T.B..

- Në përgjigje të shkresës nr. 860/2, datë 14.06.2021, së KMD-së, MSHMS dërgoi shkresën nr. 2710/1, datë 25.06.2021, nëpërmjet së cilës informon se mjeku T.B. ka punuar në Spitalin e qytetit Gramsh prej vitit 1973 dhe në vijim ka punuar si mjek pediatër në Konsultorin e fëmijës. Në muajin mars 2012, ai ka mbushur moshën e daljes në pension dhe që nga ky moment ka vazhduar të punojë pranë kësaj qendre shëndetësore duke shtyrë afatin e daljes në pension me miratimin e MSHMS, sipas një procedurë përkatëse. Z. T.B. i ishte shtyrë afati i daljes në pension për 9 vjet, nga viti 2012 deri në prill të vitit 2021.

Nëpërmjet shkresës nr. 22, datë 23.03.2021, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gramsh ka depozituar një kërkesë pranë MSHMS për shtyrje të afatit të daljes në pension për z. T.B. MSHMS ka bërë vlerësimin e kësaj kërkesë mbështetur mbi bazën e disa treguesve shëndetësorë. Meqënëse mjekët e kësaj qendre shëndetësore mbulojnë të gjitha grup moshat, pacientët e moshës pediatrike do të trajtohen nga mjekët e tjerë të kësaj qendre shëndetësore.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke siguruar mbulimin shëndetësor të pacientëve të të gjithë moshave që trajtohen në këtë qendër shëndetësore, MSHMS nuk miratoi vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të punës me mjekun T.B..

MSHMS e informon KMD se kontrata e punës së z. T.B. që prej vitit 2012 e deri në vitin 2021, ka qenë me afat të caktuar, fillimisht 1 vjeçare dhe më pas 6-mujore. Bazuar në Kodin e Punës, neni 149 “Përfundimi i kontratës me afat të caktuar”, kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Si e tillë, nuk ka vend për të përmendur procedura si afati i njoftimit, zgjidhja e kontratës së punës apo shpërblimi për vjetërsi në punë siç pretendon ankuesi. Të gjitha këto punëmarrësi do t’i fitonte nëse do të ishim para një kontrate me afat të pacaktuar.

MSHMS thekson faktin se në rastin e z. T.B. nuk ndodhemi para diskriminimit të tij pasi ky institucion e ka vlerësuar këtë mjek dhe për 9 vite i ka dhënë mundësinë për të vazhduar punën edhe pse ligji ka përcaktuar se kontrata individuale e punës është e vlefshme deri në plotësimin e moshës për daljen në pension.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 860/5, datë 03.08.2021, së KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 03.09.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së. Nëpërmjet shkresës nr. 3419/1, datë 11.08.2021, së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale drejtuar Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë (OSHKSH) dhe për dijeni KMD-së, Komisioneri u bë më dije se MSHMS i ka përcjellë për kompetencë dhe trajtim kërkesën për pjesëmarrje në seancë dëgjimore këtij Operatori.

Për sa më sipër, në seancë dëgjimore mori pjesë përfaqësuesi ligjor i ankuesit, z. E.B. dhe përfaqësuesi me autorizimin nr. 3419 prot., datë 11.08.2021, e Drejtorit të Qendrës Shëndetësore Gramsh, z. B. Ç. Në seancë, përfaqësuesi ligjor i Qendrës Shëndetësore Gramsh sqaroi se Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë (OSHKSH) kishte njoftuar zyrtarisht këtë Qendër për të kryer përfaqësimin e saj në këtë seancë. Përfaqësuesi ligjor i ankuesit parashtroi edhe një herë pretendimet e ankuesit duke vënë theksin se z. T.B. ka punuar si mjek pediatër që prej vitit 1973, pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh. Me mbushjen e moshës për pension pleqërie, ankuesi ka depozituar një kërkesë për shtyrjen e daljes në pension. Shtyrja në fjalë është përsëritur dhe ankuesi ka punuar për 9 vjet pas plotësimit të moshës për pension pleqërie, pasi pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh nuk ka patur mjek tjetër pediatër. Në vitin 2020, kontrata e punës i përfundoi dhe nuk iu rinovua sikurse i ishte kryer gjithmonë. Ankuesi e kundërshtoi gjyqësisht një gjë të tillë duke kërkuar shpërblimin për vjetërsi dhe pagat e humbura. Marrëdhënia e punës është ndërprerë për një periudhë 3 mujore dhe më pas i është lidhur një kontratë e re pune me afat të caktuar deri në datën 01.04.2021. Pas kësaj date, ankuesi ka depozituar sërish kërkesë për rinovim të afatit të kontratës së punës, por kërkesa e tij është refuzuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, Qendra Shëndetësore Gramsh i ka kërkuar rekomandim Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me mënyrën se si duhej vijuar me kërkesën e ankuesit, duke qenë se dërgimi i çështjes në gjykatë përbënte dëm ekonomik për Qendrën Shëndetësore Gramsh. Përfaqësuesi ligjor i ankuesit vuri në dispozicion të KMD-së shkresën nr. 366/1, datë 11.08.2021 “Kthim përgjigje” e Njësisë

Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gramsh dhe shkresën nr. S-17/1 prot., datë 11.08.2021, e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh etj.

Përfaqësuesi i Qendrës Shëndetësore Gramsh theksoi faktin se në asnjë rast ankuesi nuk është diskriminuar për shkakun e pretenduar. Ai lexoi parashtrimet e QSH Gramsh të nënshkruara nga Drejtoresha e kësaj qendre. Sipas parashtrimit të subjektit rezulton se në fushën e punësimit në sektorin e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë, Qendra Shëndetësore Gramsh është hierarkisht nën varësinë e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gramsh (NJVKSH), Drejtorisë Rajonale Elbasan (OSHKSH-së), Fondit të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo renditje hierarkike, si dhe komunikimi ndërmjet institucioneve është rregulluar në bazë kriteresh e procedurash ligjore, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Në parashtrimet e paraqitura, Drejtoresha e Qendrës Shëndetësore Gramsh thekson faktin se institucioni që ajo drejton, ka vepruar si institucion vartësie dhe sqaron se në sjelljen e saj institucionale nuk ka tejkalime, qëndrime të gabuara lidhur me mbajtjen e komunikimit me organet eprore. Për sa më sipër, është ndjekur procedura ligjore në fuqi që lidhet me mbushjen e moshës për pension pleqërie. Ankuesi nuk është shprehur në asnjë rast dhe asnjë shkresë se ku qëndron shkelja e kryer nga ana e QSH Gramsh, si dhe cila është sjellja diskriminuese ndaj tij në krahasim me pensionistë të tjerë. Drejtoresha e Qendrës Shëndetësore Gramsh thekson faktin se në asnjë rast dhe në asnjë komunikim shkresor që ka patur me ankuesin nuk i është cituar dispozita ligjore të cilën ajo ka shkelur, duke e lidhur me faktin që i atribuon. Drejtuesja e kësaj qendre shëndetësore kërkon, që ankuesi të sqarojë se cila është e drejta e cënuar prej saj. Ndër të tjera në parashtrimet e saj vihet në dukje fakti se gjuha e përdorur nga përfaqësuesi i ankuesit me të cilën i është drejtuar asaj në cilësinë e titullares së një institucioni është totalisht diskriminuese. Për të vërtetuar një gjë të tillë, ajo ka depozituar shkresat e datave 18.03.2021, 15.04.2021, 24.05.2021 dhe 07.06.2021, të dërguara nga përfaqësuesi i ankuesit në adresë të saj. Njëkohësisht ajo sqaron se përfaqësuesi ligjor i ankuesit është ankuar tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me pretendimin se nuk i jepen akte, ndërkohë që ajo ka qenë e gatshme për të dhënë çdo akt të administruar pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh. Ajo ka depozituar në cilësi prove shkresën nr. 52 prot., datë 08.05.2021, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën përfaqësuesin me autorizim të Qendrës Shëndetësore Gramsh, nëse pozicioni i mjekut pediatër pranë kësaj qendre ishte vakant dhe përgjigja e tij ishte pohuese. Njëkohësisht, i pyetur sërish për të dhënë argumentat përkatëse, lidhur me shkresën e dërguar në adresë të institucioneve eprore, ku Qendra Shëndetësore Gramsh informonte hollësisht mbi padinë e ankuesit dhe dëmin financiar, që mund të shkaktonte një vendim gjyqësor kundër këtij institucioni, përfaqësuesi ligjor i Qendrës Shëndetësore Gramsh sqaroi se lënda e shkresës ka qenë “*Kërkesë për rekomandim*” dhe referuar hierarkisë, kjo Qendër ka informuar MSHMS për padinë e ankuesit. Qendra Shëndetësore Gramsh financohet me buxhetin e shtetit dhe ka qenë në dilemë mbi procedurën që duhej ndjekur për kërkesën për rinovim kontrate nga ana e mjekut. I

pyetur nga përfaqësuesit e KMD-së se në kushtet kur në organikën e QSH Gramsh parashikohet një mjek pediatër dhe aktualisht me përfundimin e kontratës së punës së ankuesit, aty nuk punon asnjë mjek tjetër pediatër, si është zgjidhur çështja e lidhur me shëndetin e fëmijëve, përfaqësuesi i QSH Gramsh u shpreh se kjo çështje është zgjidhur nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mjekët e familjes mbulojnë edhe kompetencat e mjekut pediatër. I pyetur sërish mbi faktin se për sa kohë pozicioni i mjekut pediatër ishte vakant, cilat ishin arsyet që mjekut T.B. nuk iu rinovua kontrata e punës, përfaqësuesi i QSH Gramsh u shpreh se një gjë e tillë nuk ka aspak lidhje me padinë e z. T.B., që është duke u gjykuar në gjykatë, pasi emërimi i mjekëve nuk bëhet nga Qendra Shëndetësore Gramsh.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD iu drejtua me e-mail palëve duke u parashtruar se çështja mund të zgjidhet nëpërmjet ndërmjetësimit. Në këtë kontekst, KMD u vuri në dukje palëve se nëse do të arrihej një marrëveshje ndërmjet tyre, kjo marrëveshje duhet t'u bëhej e ditur Komisionerit brenda 10 ditëve.
- Për sa më sipër, në kushtet kur një marrëveshje e tillë nuk u arrit, KMD iu drejtua me e-mail Drejtoreshës së Qendrës Shëndetësore Gramsh, duke i kërkuar informacionin e poshtëcitur:
 1. Numri i mjekëve pranë QSH Gramsh (dhe specialiteti përkatës), që edhe pse kanë mbushur moshën për pension, iu është shtyrë dalja në pension, duke lidhur kontrata pune me afat te caktuar. Në këtë kontekst, të cilësohet se sa ka qenë periudha përgjatë së cilës kanë punuar me kontrata me afat të caktuar, pas mbushjes së moshës së pensionit;
 2. Sa prej mjekëve të sipërcituar nuk është rinovuar kontrata e punës, sikurse ankuesit, përgjatë periudhës janar 2020 e në vijim dhe arsyet përkatëse;
 3. Të dërgohen praktikat shkresore të ndjekura për komunikim me institucionet eprore, për mjekë të tjerë, të cilëve u është shtyrë moshja e pensionit, duke punuar nëpërmjet kontratave të punës me afat te caktuar;
- Në përgjigje të emailit të KMD-së, Drejtoresha e Qendrës Shëndetësore informoi se: *Qendra Shëndetësore Gramsh në Strukturën e saj organike të miratuar nga MSHMS ka gjithsej 7 (shtatë) mjekë, 17 (shtatëmbëdhjetë) infermierë, 1 (një) sanitare, gjithsej 25 punonjës me kohë të plotë, si dhe 1 (një) ekonomist me kohë të pjesshme. Nga 7 (shtatë) mjekë, sipas strukturës, 6 (gjashhtë) janë mjekë të përgjithshëm familje dhe 1 (një) mjek specialist pediatër. Aktualisht pranë kësaj qendre shërbejnë 5 (pesë) mjekë të përgjithshëm familje. Asnjë prej 5 (pesë) mjekëve nuk ka mbushur moshën e daljes në pension, kështu që kontratat e tyre të punës janë lidhur pa afat.” Lidhur me çështjen e dytë dhe të tretë, Drejtoresha e QSH Gramsh sqaron se: “Asnjë prej mjekëve që shërbejnë pranë QSH Gramsh nuk janë në kushtet e shtyrjes së kontratës pasi nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension. Edhe gjatë vitit 2020 në QSH Gramsh nuk ka patur mjek të tjerë që t’u jetë rinovuar kontrata e punës, pasi*

nga të gjithë mjekët kanë qenë dhe janë me kontratë pa afat, përveç mjekut pediatër z. T.B.. QSH Gramsh nuk ka patur praktika të tjera shkresore të ndjekura për komunikim me institucionet eprorë, për mjekë të tjerë, të cilëve u është shtyrë moshë e daljes në pension. E theksojmë edhe një herë se, asnjë nga mjekët që ka punuar dhe vazhdon të punojë pranë QSH Gramsh, nuk ka qenë në kushtet e shtyrjes së kohës së daljes në pension, pasi nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension. Duke vlerësuar edhe dokumentat arkivore të QSH Gramsh, rezultoi se që nga krijimi i saj nuk ka patur asnjë rast të tillë.”

- Në vijim të shqyrtimit të ankësës, KMD iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe për dijeni ankuesit, nëpërmjet shkresës nr. 1635 prot., datë 25.11.2021, ku MSHMS i kërkohej informacioni i mëposhtëm:
 1. Praktika të tjera, të ndjekura nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në institucione apo qendra shëndetësore të qyteteve të tjera, të Shqipërisë, ku nuk është rinovuar kontrata e punës, për mjekët që kanë kërkuar shtyrje të afatit për daljen në pension, pasi shfaqin vullnet për të punuar edhe pasi kanë mbushur moshën e pensionit, pasi është gjykuar që ngarkesa e tyre e punës, t’u ka kalojë mjekëve të tjerë të institucioneve respektive. Të dërgohen kopje të praktikave të sipërcituara;
 2. Numri total i mjekëve, që aktualisht punojnë tej moshës së pensionit, nëpërmjet kontratave me afat të caktuar. Sa herë u është rinovuar kontrata e punës me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë?
 3. Informacion mbi moshën maksimale të mjekëve, që punojnë ende tej moshës së pension;

Komisioneri kërkoi që informacioni i kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të dërgohej brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni mbi shkresën e sipërcituar.

- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dërgoi shkresën nr. 2710/2, datë 14.12.2021, nëpërmjet së cilës informon se: *“Z. T.B. ka punuar në spitalin e qytetit të Gramshit që prej vitit 1973 dhe më pas ka punuar pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh në pozicionin mjek pediatër në Konsultorin e Fëmijës. Në muajin mars 2012 ka mbushur moshën e daljes në pension dhe që nga ky moment ka vazhduar të punojë pranë kësaj qendre shëndetësore duke shtyrë herë pas here afatin e daljes në pension me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas një procedure përkatëse. Z. T.B. i është shtyrë afati i daljes në pension për nëntë vite, ë prej vitit 2012 deri në prill të vitit 2021.*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të disa treguesve shëndetësorë vlerëson çdo kërkesë për shtyrje të afatit të daljes në pension për mjekët rast pas rasti sipas nevojave të saj duke patur si qëllim kryesor mbulimin me shërbim shëndetësor të gjithë popullatës në të gjithë vendin. Pra, është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vlerësuar

nëse duhet apo jo të shtyhet afati i daljes në pension për çdo personel mjekësor. Për sa më sipër, nisur nga fakti që z. T.B. i është shtyrë pensioni për nëntë vjet do të thotë që ky mjek është vlerësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke i dhënë mundësi atij për të vazhduar punën për disa vite. Në përfundim theksojmë se nuk kemi të bëjmë aspak me diskriminim ndaj ankuesit dhe se aktualisht një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është punësimi i mjekëve të rinj të sapodiplomuar, duke plotësuar pozicionet vakante në të gjithë sistemin shëndetësor.”

- Në përgjigje të shkresës nr. 1635 prot., datë 25.11.2021, së KMD-së, z. E. B, përfaqësues ligjor, i ankuesit T.B. dërgoi shkresën nr. 1637/1, datë 03.12.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se: *“Me shkresën nr. 566/1 prot., datë 11.08.2021, Qendra Shëndetësore Gramsh e ka informuar palën ankuese lidhur me numrin e mjekëve të punësuar pranë saj (gjithsej 14 mjekë), vakancën e mjekëve në institucion (5 vende) si edhe për moshën më të madhë të mjekut në detyrë, konkretisht 81 vjeç (jo ankuesi). Këtë shkresë që pasqyron informacion lidhur me rrethën e Gramshit e kemi vënë në dispozicionin Tuaj. Siç e kemi bërë të ditur me ankimin e paraqitur dhe sic del nga shkresat e administruara, ankuesi ishte i vetmi mjek pediatër i punësuar pranë qendrës shëndetësore e të mbulonte nevojat e konsultores së fëmijës në qytetin e Gramshit (shërbimi parësor). Pranë konsultores së fëmijës merret ekskluzivisht shërbimi parësor për fëmijë deri në moshën 6 vjeç duke u ndjekur ecuria e tyre e zhvillimit psikik dhe fizik, si dhe vaksinimi i popullatës deri në moshën 19 vjeç. Për këtë qëllim mbahen evidenca në kartelën mjekësore të fëmijës. Kuptueshëm, pranë konsultores kryhen edhe vizita të paplanifikuara. Në varësi të gjendjes shëndetësore të fëmijës, shërbimi parësor rekomandon (i) mjekim dhe/apo regjim shtrati, (ii) vizitë të specializuara pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza (posaçërisht për diagnostikimin me aparatura të posaçme, të cilat nuk gjenden në Gramsh apo (iii) regjim spitalor pranë Spitalit Gramsh.*

Në kuptim të nenit 9, të Ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” ankuesi ka qenë pjesë e shërbimit parësor, pra kontakti i parë i pacientit me mjekun. Neni 6, i Ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” e detyron Ministrinë e Shëndetësisë që në bashkëpunim me pushtetin lokal të marrë masat për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor parësor. Për dijeninë tuaj, ambientet e konsultorit të fëmijës ishin pranë Spitalit Gramsh. Me zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin, këto ambiente janë transferuar tashmë pranë qendrës shëndetësore. Sipas pohimeve të dhëna në seancën dëgjimore të zhvilluar, ngarkesa është shpërndarë te mjekët e përgjithshëm dhe se kjo nuk përbën asgjë të çuditshme!!!

Ndërkohë, duhet theksuar edhe se, referuar shkakut zyrtar të dhënë, kontrata e punës me ankuesin është zgjidhur për shkak të përfundimit të afatit të saj. Ndryshe nga shkak i dhënë zyrtarisht me shkresën nr. 28 prot., datë 16.03.2021, më pas është pretenduar një herë si shkak

për zgjidhjen moshë e ankuesit (për këtë qëllim kemi depozituar qendrimin që është mbajtur në gjykatë nga qendra shëndetësore) dhe më pas është pretenduar si shkak numri i vizitave (qendrimi në seancë dëgjimore).

Shkaku që lidhet me moshën e ankuesit përbën tjetër shkak diskriminues ndërkohë që pretendimet lidhur me numrin e vizitave nuk qendrojnë sepse konsultori i fëmijës Gramsh sot nuk ka në organikë mjek peditër.

Sollëm sa më sipër në vemendjen Tuaj kryesisht për (tre) arsye:

- 1. Për të nxjerrë në pah qendrimin kontradiktor të qendrës shëndetësore dhe ministrisë së linjës lidhur me shkakun e zgjidhjes;*
- 2. Për të theksuar edhe një herë faktin se pranë qendrës shëndetësore nuk ka mjek peditër (fakt që del edhe nga cdo shkresë që qendra shëndetësore i ka drejtuar ministrisë). Në këto kushte nuk mund të flitet për shpërndarje të natyrshme të ngarkesës te mjekët e tjerë. Ngarkesa dhe shpërndarja e punës do të kishin shumë relevancë në rast se pranë qendrës shëndetësore do të kishte të tjerë mjekës peditër të punësuar. Sipas kësaj logjike që ndjek në mënyrë të sforcuar qendra shëndetësore dhe ministria e linjës, meqënëse në Spitalin e Gramshit kryhen p.sh. 5 operacione, të ndërpritet kontrata e punës me kjequn kirurg dhe kjo ngarkesë të shpërndahet te mjekët e tjerë me profilizime të ndryshme.*
- 3. Mos rinovimi i kontratës me ankuesin dhe mos marrja e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për mbushjen e vakancës së krijuar në mënyrë të paligjshme me mjek të ri peditër ka çënuar dhe vazhdon të çënojë ofrimin e shërbimit parësor në rrethin e Gramshit.”*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove gjatë hetimit administrativ të ankesës, rezulton se mjeku T.B. ka punuar që prej vitit 1973 pranë Spitalit të Gramshit e në vijim pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh. Në vitin 2012, ankuesi ka mbushur moshën për pension pleqërie dhe në bazë të nenit 31, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet shprehimisht: “1. Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur

të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92⁸, të këtij ligji”, z. T.B. duhet të dilte në pension pleqërie. Pavarësisht kësaj, ankuesi ka vazhduar të punojë në pozicionin e mjekut peditër, pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, nëpërmjet kontratave me afat të caktuar, duke e shtyrë afatin e pensionit të pleqërisë për një periudhë 9-vjeçare. Kontratat e punës janë nënshkruar nga ankuesi dhe drejtoresha e Qendrës Shëndetësore Gramsh. Kompetenca e titullares për të lidhur marrëdhëniet e punës me mjekët dhe personelin e qendrës përcaktohen në bazë të nenit 8, pika 4, germa c) të Urdhërit nr. 389, datë 07.05.2019, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e statutit të Qendrës Shëndetësore”, sipas së cilit drejtori i Qendrës Shëndetësore lidh kontratat e punës me punonjësit e Qendrës Shëndetësore, bazuar në procedurat e rekrutimit të personelit të miratuara nga MSHMS.

Procedura e ndjekur për shtyrjen e daljes në pension së z. T.B., përfshinte kërkesën formale të ankuesit, e cila përcillej nga Qendra Shëndetësore Gramsh tek organi i saj epror i drejtpërdrejtë, i përkatësisht NJVKSH. Kjo e fundit e përcillte për kompetencë tek Drejtoria Rajonale Elbasan e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH-së), e në vijim kjo e fundit e dërgonte kërkesën pranë Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH). Më pas kërkesa e mjekut kalonte pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila jepte miratimin përkatës për shtyrjen e afatit për daljen në pension të ankuesit.

Në këtë kontekst, vlen për t’u theksuar fakti se procedura në tërësi që përcakton se kur duhej të merrej parasysh kërkesa e një mjeku për të punuar tej moshës së pensionit është përcaktuar më në detaje, nëpërmjet shkresës nr. 514/44, datë 24.04.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale drejtuar Drejtorisë Rajonale Elbasan të OSHKSH-së, ku ndër të tjera⁹, përcaktohet dhe saktësohet edhe procedura që duhej ndjekur për rastet e shtyrjes së afateve për dalje në pension. Kështu në këtë shkresë citohet: “...Çdo pozicion që parashikohet të mbetet vakant nga dalja e personelit në pension, të analizohet të paktën 2 (dy) muaj përpara krijimit të vendit vakant, nëse është i domosdoshëm apo mund të kryhet shpërndarja e pacientëve tek mjekët e tjerë të institucionit shëndetësor. Në rast se vlerësoni se pozicioni nuk është i nevojshëm (bazuar në normativën aktuale – numër banorësh dhe vizita të kryera gjashtëmuajorin e fundit) ju duhet t’i drejtoheni Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së përmes një vlerësimi për ndryshim të strukturës (shkurtim pozicioni). Në rast të kundërt nëse vlerësohet se pozicioni është i domosdoshëm, fillimisht ju duhet t’u propozoni këto pozicione pune mjekëve që kanë aplikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë” dhe janë në listë pritjeje sipas renditjes përkatëse. Nëse mjekët e listës së pritjes refuzojnë pozicionin e ofruar, mund të vijoni me përcjelljen e kërkesës pranë

⁸ Referuar nenit 92 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSF” i ndryshuar, parashikohet se moshë dhe periudha e sigurimit për pension pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohet në pikën 1, të nenit 31, të këtij Ligji, do të rriten sipas tabelave përkatëse të përcaktuara në këtë nen.

⁹ Nëpërmjet kësaj shkrese përcillet edhe refuzimi lidhur me kërkesën e z. T.B. për shtyrje të daljes në pension.

Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së. Kërkesa duhet të shoqërohet me procesverbalin e mbajtur për refuzimet e pozicionit nga ana e kandidatëve”.

Shtyrja e afatit të daljes në pension të mjekut pediatër T.B. është kryer për 9 vite në vijim dhe marrëdhënia e punës është rregulluar nëpërmjet kontratave të punës me afat të caktuar 6-mujor, të cilat janë nënshkruar nga ankuesi dhe titullarja e QSH Gramsh. Këto kontrata kanë qenë të njëpasnjëshme, deri kur fillimisht nëpërmjet shkresës nr. 514/44, datë 24.04.2020 dhe në vijim me anë të shkresës nr. 12/443, datë 25.06.2020, Ministria e Shëndetësisë ka refuzuar kërkesën e ankuesit për shtyrje të afatit për pension, duke u mbështetur në arsyen se ky pozicion pune duhej shpallur vakant dhe duhet t’ju ofrohej fillimisht kandidatëve, të cilët do të aplikonin në platformën “Mjekë për Shqipërinë”, procedurë kjo që nuk ishte kryer paraprakisht nga ana e institucioneve përgjegjëse. Në vijim të shkresave të sipërcituara, Drejtoresha e Qendrës Shëndetësore Gramsh, miratoi Urdhërin nr. 3, datë 03.07.2020 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të z. T.B.”. Ndërkohë që, në datën 20.09.2020 është shpallur vakant pozicioni i mjekut pediatër, në Platformën Elektronike “Mjek për Shqipërinë”.

Pas një periudhe disa mujore, në kushtet ku nuk ka patur interes për pozicionin e punës së mjekut pediatër pranë QSH Gramsh, ankuesi ka lidhur sërish kontratë pune me Qendrën Shëndetësore Gramsh, pasi MSHMS e ka miratuar kërkesën e tij për të punuar, nëpërmjet shkresës nr. 12/819, datë 29.09.2020 me lëndë “Miratim kërkesë”. Kontrata e fundit e lidhur ndërmjet mjekut T.B. dhe Qendrës Shëndetësore Gramsh kishte afat të caktuar 6 mujor, përkatësisht prej datës 02.10.2020 deri në datën 01.04.2021.

Ndërkohë që, në datën 27.11.2020, ankuesi ka paditur gjyqësisht Qendrën Shëndetësore Gramsh pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰, duke kërkuar shpërblim nga punëdhënësi, si vijon: 3 paga mujore për shkaqe të pajustificuara të zgjidhjes së menjëherëshme të kontratës së punës në bazë të nenit 155 të Kodit të Punës; 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit; 2 paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; 23.5 paga shpërblim për vjetërsi dhe 3 (tre) paga mujore për leje të pakryer. Padia ka lidhje me ato muaj, kur ankuesi mbeti i papunë si pasojë e Urdhërit nr. 3, datë 03.07.2020, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të z. T.B.”. Mbi faktin e sipërcituar, Qendra Shëndetësore Gramsh u njoftua nëpërmjet Dëftesës së Komunikimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me aktin e njoftimit të padisë nr. 13765/2020, datë 21.12.2020. Kjo çështje është ende në shqyrtim gjyqësor.

Në muajin janar 2021, mjeku T.B. ka depozituar pranë punëdhënësit, kërkesën e tij të datës 11.01.2021, nëpërmjet së cilës kërkon të vazhdojë punën si mjek pediatër pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, pasi në datën 01.04.2021, kontrata e punës me afat 6-mujor përfundonte.

¹⁰ Referuar kërkesëpadisë së z. T.B. të depozituar në cilësi provë pranë KMD-së. Sipas këtij akti, padia është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, pala e paditur ka kërkuar kalimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Pas depozitimit të kësaj kërkesë, Qendra Shëndetësore Gramsh ka dërguar shkresën nr. 9, datë 26.01.2021 pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan të OSHKSH-së dhe për dijeni MSHMS dhe Drejtorisë Qendrore të OSHKSH Tiranë dhe ankuesit T.B.¹¹, nëpërmjet së cilës përcjell kërkesën e mjekut për shtyrje të afatit për dalje në pension, si dhe informon mbi padinë e tij në gjykatë dhe dëshpërbimin, që ai kërkon nga Qendra Shëndetësore Gramsh. Në shkresën e sipërpërmendur citohet: *“Dëmi i shkaktuar nga kjo padi shkon në 2,014,850 lekë shumë, e cila është e barabartë me pagat e gjithë stafit të QSH Gramsh për 2 muaj.....Ngarkesa e tij në punë për 6 mujorin e fundit është 877 vizita. Pra, ngarkesa ditore (dhjetë vizita në ditë nuk arrihet dhe është sa gjysma e ngarkesës normale ligjore. Gjithsesi mjeku T.B. vazhdon nëpërmjet avokatit të tij çështje gjyqësore, të cilat gjithësesi janë e drejtë e tij. Së fundmi, ju informoj se mjeku T.B. ka paraqitur një kërkesë pranë QSH Gramsh, ku kërkon shtyrje të kohës së daljes në pension. Procedura që ndiqet në këtë rast është që pas kërkesës së mjekut, ne si QSH duhet t’i drejtohem NJVKSH Gramsh, e cila nga ana e saj përcjell kërkesën institucionit tuaj. Pikërisht, ky është shqetësimi ynë, si duhet të vepohet në këtë rast, pasi në Statutin e QSH-së apo udhëzime të tjera nuk parashikohen zgjidhje për këto problematika. Me këtë rast dua të sjell në vëmendjen Tuaj se mjeku T.B. ka shkelur parimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit, të mirëpërcaktuara në Kodin e Punës së RSH, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. Për sa më sipër, me qëllim final ofrimin e shërbimit shëndetësor për komunitetin, por dhe ruajtjen e interesave të QSH që unë drejtoj, kërkoj nga Ju rekomandime të mëtejshme pasi jam përballë një dileme nëse duhet ose jo të dërgoj kërkesën për shtyrje të kohës së daljes në pension të mjekut T.B.. Jam në pritje të rekomandimeve Tuaja lidhur me çështjen.”*

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se nëpërmjet shkresës nr. 28 prot., datë 16.03.2021, me lëndë: *“Njoftim për ndërprerjen e kontratës së punës”*, Qendra Shëndetësore Gramsh e ka njoftuar ankuesin se kontrata e tij e punës përfundon në datën 01.04.2021 dhe për këtë arsye marrëdhëniet e tij të punës me punëdhënësin përfundojnë në këtë datë.

Ndërkohë që, në vijim të shkresës nr. 9, datë 26.01.2021, të QSH Gramsh, Drejtoria Qendrore e OSHKSH-së i është drejtuar Qendrës Shëndetësore Gramsh nëpërmjet shkresës nr. 935/2, datë 12.04.2021, ku e bën me dije se me anë të shkresës nr. 12/159, datë 06.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, nuk miratohet shtyrja e afatit të daljes në pension të z. T.B.. Shkresa e sipërcituar e MSHMS-së është dërguar për njohje dhe zbatim bashkëlidhur shkresës nr. 935/2, datë 12.04.2021, së Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së.

¹¹ Ankuesi pretendon se shkresa nr. 9/2021 e QSH Gramsh nuk i është dërguar zyrtarisht, por ai ka marrë dijeni mbi të në mënyra të tjera.

Për sa më sipër, rezulton se QSH Gramsh e ka përfunduar marrëdhënien e punës me ankuesin, me përfundimin e kontratës me afat të caktuar 6 mujor. Në vijim të shkresave të sipërcituara, kjo Qendër nuk e ka rinovuar më kontratën e punës me z. T.B.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se pozicioni i mjekut pediatër pranë QSH Gramsh ishte ende vakant dhe ngarkesa e këtij pozicioni i ishte shpërndarë mjekëve të familjes. Kjo zgjidhje është konsideruar si opsion më i mirë, sesa opsioni për marrjen në konsideratë të kërkesës së mjekut T.B., për t'i rinovuar kontratën e punës për një afat tjetër 6 mujor. Në këtë kontekst, KMD gjykon se përmbajtja e shkresës nr. 9, datë 26.01.2021, së QSH Gramsh ka qenë dhe arsyeja e mosmiratimit të shtyrjes së afatit për dalje në pension të mjekut, nga ana e MSHMS. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj shkrese rezulton se është paragjykuar e drejta e ankuesit për zhdëmtim në përputhje me ligjin, lidhur me pretendimin e tij se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të QSH Gramsh. Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se kjo është një e drejtë kushtetuese, që parashikohet shprehimisht në nenin 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku citohet: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”* Për sa kohë që, ankuesi ka vlerësuar se Qendra Shëndetësore Gramsh duhet ta dëmshpërblejë për ndërmarrjen e veprimeve të pretenduara si të padrejta ndaj tij, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Në shkresën nr. 9, datë 26.01.2021, të Qendrës Shëndetësore Gramsh nuk është bërë thjesht një informim i organit epror, prej të cilit është pretenduar të jepen rekomandime mbi situatën në fjalë. Qendra Shëndetësore Gramsh, nëpërmjet kësaj shkrese ka vënë në dukje faktin se ky mjek ka shkelur parimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit, të mirëpërcaktuara në Kodin e Punës së RSH, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. Në këtë shkresë, drejtuesja e kësaj qendre shprehet: *“... jam përballë një dileme nëse duhet ose jo të dërgoj kërkesën për shtyrje të kohës së daljes në pension të mjekut T.B..”* Në këtë kontekst, Komisioneri çmon, se procedura mbi kërkesa të tilla është e mirë sqaruar në shkresën nr. 514/44, datë 24.04.2020, e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku citohet se: *“.....Në rast të kundërt nëse vlerësohet se pozicioni është i domosdoshëm, fillimisht ju duhet t'u propozoni këto pozicione pune mjekëve që kanë aplikuar në portalin “Mjekë për Shqipërinë” dhe janë në listë pritjeje sipas renditjes përkatëse. Nëse mjekët e listës së pritjes refuzojnë pozicionin e ofruar, mund të vijoni me përcjelljen e kërkesës pranë Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së. kërkesa duhet të shoqërohet me procesverbalin e mbajtur për refuzimet e pozicionit nga ana e kandidatëve”.*

Në nenin 11/1, të Kodit të Punës parashikohet shprehimisht: *“Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve, punëdhënësit, përfaqësuesit e punëdhënësve, punëmarrësit dhe përfaqësuesit e punëmarrësve duhet të udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, drejtësisë dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Ata informojnë njëri-tjetrin për të gjitha faktet, kushtet, si dhe ndryshimet e tyre, të cilat janë të rëndësishme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e*

detyrimeve.” Për sa më sipër, KMD gjykon se shkelja e parimit të mirëbesimit në asnjë rast nuk mund të konsiderohet ushtrimi i një të drejte të sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Mjeku T.B., në asnjë rast, nuk ka refuzuar të bashkëpunojë me punëdhënësin për përmbushjen e detyrimeve të tij, si dhe asnjëherë nuk ka cënuar parimin e mirëbesimit duke kryer shkelje të rënda apo të lehta në mënyrë të përsëritur, në punë.

Gjithashtu, nga analizimi i hollësishëm i përcaktimeve të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Komisioneri gjykon se në asnjë rast punëmarrësi T.B. nuk ka kryer shkelje të këtij Kodi dhe e drejta e tij për t’iu drejtuar gjykatës nuk bën pjesë në cënimin e mirëbesimit dhe bashkëpunimit me punëdhënësin.

Pavarësisht faktit se në lidhjen e një kontrate punësimi duhet të ekzistojë liria kontraktore punëmarrës-punëdhënës dhe kontrata në vetëvete është një akt dakordësie ndërmjet dy palëve, të cilat shprehin vullnetin e tyre lirisht për të hyrë në marrëdhënie punësimi, duke marrë përsipër detyrime dhe duke gëzuar të drejtat respektive, në rastin konkret Komisioneri gjykon se Qendra Shëndetësore Gramsh ka pasur tendencë jo pozitive ndaj ankuesit, pasi ka interpretuar si cënim të parimit të mirëbesimit, veprimin e tij, në zbatim të një të drejte kushtetuese. Kjo e ka penalizuar ankuesin, duke marrë një akt refuzimi nga organi epror Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me vazhdimin e marrëdhënies së punësimi.

Edhe gjatë seancës degjimore, u theksua fakti se pozicioni i mjekut pediatër është ende vakant dhe detyra e tij kryhet nga mjekët e familjes. Vakanca e këtij pozicioni, shpjegohet si pasojë e mosinteresimit të mjekëve të tjerë në portalin “Mjekë për Shqipërinë”. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se nuk ekzistonte asnjë arsye për mos rinovimin e kontratës së z. T.B., i cili është i aftë për të ushtruar detyrat e tij¹². Në shkresën nr. 9/2021 të Qendrës Shëndetësore Gramsh është cituar edhe ngarkesa jo e madhe e mjekut gjatë 6-mujorit të fundit të punësimi të tij. Numri i vizitave ditore ka qenë më i vogël se 10 të tilla që është norma ditore. Në këtë kontekst, KMD gjykon se numri i vizitave shëndetësore nuk mund të jetë i njëjtë në të gjitha periudhat përgjatë një viti ose disa vjetëve.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se refuzimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të mundësisë së rinovimit të kontratës së punësimi për z. T.B., përbën në vetvete një veprim të padrejtë dhe disfavorizues ndaj tij. KMD gjykon se MSHMS është mbështetur në informacionin e dërguar nga QSH Gramsh dhe ka refuzuar lidhjen e një kontrate vijuese me mjekun T.B., duke preferuar që ngarkesa e pozicionit të tij të punës, t’i kalojë 5 (pesë) mjekëve të familjes, që punojnë në këtë Qendër.

¹² Referuar Vërtetimit të Komisionit për caktimin e aftësisë në punë, të lëshuar për mjekun T.B.

Komisioneri gjykon se Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Shëndetësore Gramsh e kanë ekspozuar ankuesin ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në nenin 1, të LMD të ndryshuar, listohen një sërë shkaqesh, për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi. Dispozita në fjalë mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera, që nuk janë listuar në të.

Për sa më sipër, neni i ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹³.

Për sa më sipër, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet KEDNJ në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e saj.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye, një karakteristikë personale, që e bën të dallueshëm një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

¹³ Neni 14, i KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij, që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*, për të cilën ankuesi ka sqaruar se ka të bëjë me ankimin e tij në gjykatë, pasi në vijim të një ankimi të tillë, janë ndërmarrë veprime të caktuara në disfavor të tij.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Në vlerësim të pretendimeve të ankuesit, Komisioneri ka çmuar të shqyrtojë dhe analizojë kërkesën e z. T.B. lidhur me pasojat e ardhura menjëherë pas ankimimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, ku ka kërkuar dëmshpërblim nga punëdhënësi për periudhën disa mujore që ka qenë pa punë si pasojë e Urdhërit nr. 3, datë 03.07.2020, të Drejtores së QSH Gramsh, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të z. T.B.”.*

Në analizën e tij, KMD ka dalë në përfundimin se mjeku T.B. është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Shëndetësore Gramsh, pasi me veprimet e tyre kanë paragjykuar të drejtën e ankuesit për zhdëmtim në përputhje me ligjin, lidhur me pretendimin e tij se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të QSH Gramsh. Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se kjo është një e drejtë kushtetuese, që parashikohet shprehimisht në nenin 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku citohet: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “*në gëzimin e të drejtave dhe lirive*” të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁴

Konventa nr. 111, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁵ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara, i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “*diskriminim*” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit është ripohuar si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s¹⁶ që prej adoptimit në vitin 1998 të “*Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos këtë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrajnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane¹⁷ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: “*Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht*”.

¹⁴ https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

¹⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁶ International Labor sOrganization (Organizata Botërore e Punës)

¹⁷ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim...”*.

Në këtë kuadër, në *“Kartën Sociale Europiane”* të rishikuar¹⁸, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa c) parashikohet se: *“Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit: c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelje të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente”*.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, pika 5, germa c) të tij ka parashikuar se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁹. Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Pretendimi i subjektit ankues qendron në faktin se shkak për diskriminimin ndaj tij është ankimi në gjykatë kundër Qendrës Shëndetësore Gramsh.

Procesi i të provuarit në një çështje diskriminimi nuk është i lehtë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë një individ në mënyrë të disfavorshme e të padrejtë, për një shkak të caktuar. Nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si prova, si vijon: *“...faktet e mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat*

¹⁸ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

¹⁹ Referuar nenit 3, pika 17, të LMD, të ndryshuar.

mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht²⁰”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative²¹ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast QSH Gramsh dhe MSHMS, të cilat duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar gjithashtu se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast QSH Gramsh dhe Ministria e Shëndetësisë, që duhet të provojnë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të ankimimit në gjykatë.

²⁰GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

²¹ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS²² gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.²³

Në këtë kontekst, QSH Gramsh ka sqaruar se nuk është organi vendimmarrës, lidhur me refuzimin e rinovimit të kontratës së punës së mjekut T.B., pasi këtë tagër e ka MSHMS, ndërkohë që nga hetimi i KMD-së rezultoi se shkresa nr. 9/2021 e kësaj Qendre ka qenë arsyeja, përse mjekut T.B. nuk i është rinovuar kontrata e punës me afat të caktuar dhe MSHMS ka refuzuar vazhdimin e punësimit me këtë mjek. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj shkrese rezultoi se është paragjykuar e drejta e ankuesit për zhdëmtim në përputhje me ligjin, lidhur me pretendimin e tij se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të QSH Gramsh. Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se kjo është një e drejtë kushtetuese, që parashikohet shprehimisht në nenin 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për sa kohë që, ankuesi ka vlerësuar se Qendra Shëndetësore Gramsh duhet ta dëmshpërblejë për ndërmarrjen e veprimeve të pretenduara si të padrejta ndaj tij, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Në këtë sens, përgjegjësia bie edhe mbi MSHMS në cilësinë e institucionit epror.

Ankuesi ka punuar për 9 vite rresht pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, si mjek pediatër, duke lidhur në mënyrë të përsëritur, kontrata pune me afat të caktuar, ndërkohë që vetëm pas ankimit të tij në gjykatë kundër QSH Gramsh, marrëdhëniet e tij të punës përfundojnë definitivisht, edhe pse pozicioni i punës së mjekut pediatër është ende vakant pranë QSH Gramsh. KMD gjykon gjithashtu se fëmijëve të qytetit të Gramshit u është mohuar e drejta për të

²² Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

patur mjekun e tyre pediatër, aq më tepër në një periudhë shumë të vështirë pandemie. Në kushtet e pandemisë Covid-19, kur mjekët e familjes pranë Qendrës Shëndetësore Gramsh, sikurse të gjithë mjekët e tjerë me profil të tillë dhe jo vetëm, në qendrat shëndetësore në mbarë Shqipërinë, kanë ngarkesë të konsiderueshme pune, sidomos me pacientët e infektuar me Covid-19, atyre u është lënë edhe ngarkesa e punës së mjekut pediatër.

Në Spitalin Rajonal Gramsh²⁴ e ushtrojnë profesionin e tyre 6 mjekë, që edhe pse e kanë mbushur moshën për pension, punojnë ende me kontrata punë me afat të caktuar, të rinovuara. I njëjti fakti vihet në dukje edhe për qendra të tjera shëndetësore të mbuluara nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gramsh. Referuar shkresës nr. 566/1, të kësaj Njësie drejtuar ankuesit, rezulton se në qendra të tjera shëndetësore që mbulohen nga NJVKSH Gramsh punojnë ende 2 mjekë që kanë mbushur moshën për pension, ku moshja maksimale e tyre është 81 vjeç.

Komisioneri gjykon se pavarësisht faktit se në lidhjen e një kontrate punësimi duhet të ekzistojë liria kontraktore punëmarrës-punëdhënës dhe kontrata në vetëvete është një akt dakordësie ndërmjet dy palëve, të cilat shprehin vullnetin²⁵ e tyre lirisht për të hyrë në marrëdhënie punësimi, duke marrë përsipër detyrime dhe duke gëzuar të drejtat respektive, në rastin konkret është konstatuar se Qendra Shëndetësore Gramsh ka pasur tendencë jo pozitive ndaj ankuesit, pasi ka interpretuar si cënim të parimit të mirëbesimit dhe bashkëpunimit, veprimin e tij, në zbatim të një të drejte kushtetuese.

Në analizë sa më sipër, KMD gjykon se QSH Gramsh dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të provonin se pretendimi i ankuesit ishte i pabazuar në fakte e prova dhe se veprimet e tyre ishin të ligjshme, të drejta, proporcionale, të arsyeshme dhe të justifikuara objektivisht, ndërkohë që mbështetur në rezultatet e hetimit administrativ kjo nuk rezulton e provuar.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se refuzimi i rinovimit të kontratës së punës me afat të caktuar të z.T.B. nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfundimi i marrëdhënieve të punës nga ana e Qendrës Shëndetësore Gramsh, është bërë për shkak të ankimimit të tij në gjykatë, duke e diskriminuar ankuesin për këtë shkak.

²⁴ Referuar shkresës nr. 517/1, datë 11.08.2021, të Spitalit Rajonal Gramsh drejtuar z. Eno T.B., përfaqësues ligjor i ankuesit.

²⁵ Referuar nenit 660 të Kodit Civil, ku parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.”*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenit 3/17, nenin 7, pikën 1, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 7/1, 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të z. T.B. për shkak të ankimit në gjykatë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Shëndetësore Gramsh.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak – për shkak të ankimit në gjykatë
Fusha – Punësim
Lloji vendimit - diskriminim

